



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. ____ prot.

Tiranë, më 20.9.2019

Lënda: Parashtrimet e Komisionerit Publik në seancën gjyqësore pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit, datë 20.9.2019, për çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit z. Besnik Muçi

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues!

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me anë të vendimit nr. 58, datë 1.8.2018, ka konfirmuar në detyrë subjektin e rivlerësimit, z. Besnik Muçi, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë.

Ndaj vendimit të Komisionit, Komisioneri Publik, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pika 2, të aneksit të Kushtetutës dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka ushtruar të drejtën e ankimit, duke kërkuar ndryshimin e këtij vendimi.

Ankimimi i këtij vendimi erdhi pasi nga analiza tërësore e:

- (i) provave të administruara nga hetimi administrativ i Komisionit;
- (ii) provave dhe akteve të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit me deklaratën “Vetting”¹;
- (iii) analizës financiare mbi verifikimin e gjendjes pasurore të deklaruar nga subjekti, personat e lidhur/të tjerë të lidhur me të, nga deklarimi i parë (2004) deri në deklaratën “Vetting” 2017;

Komisioneri Publik vlerëson se vendimi i Komisionit nuk është i drejtë dhe në pajtueshmëri me aktet dhe provat e administruara. Subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e mosdeklarimit saktësisht dhe plotësisht të pasurisë, si dhe nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të tyre. Si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, në referencë të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

I. VLERËSIMI I KOMISIONERIT PUBLIK

¹ Referuar nenit 32/1, të ligjit nr. 84/2016 dhe udhëzimit nr. 4095 prot., datë 10.10.2016, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së.

1. Kontrollin dhe vlerësimin e pasurisë, si një ndër tri kriteret e procesit të rivlerësimit kalimtar, e gjejmë në nenin D të aneksit të Kushtetutës dhe nenet 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, ku realizimin e qëllimit të nenit 179/b, pika 1, të Kushtetutës, këto norma e konkretizojnë në identifikimin e subjekteve: (i) që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht ose (ii) ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur. Si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit ka detyrimin kushtetues për të shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave, dhe nuk duhet të fshehtë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij dhe personave të lidhur me të.

2. Rezulton se subjekti i rivlerësimit, në zbatim të nenit D, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, më datë 26.1.2017, ka dorëzuar pranë ILDKPKI-së deklaratën e pasurisë “Vetting”, nga krahasimi i së cilës me deklaratat periodike të pasurisë, referuar nenit 32/5, të ligjit nr. 84/2016, subjekti, ndër të tjera, ka deklaruar këto pasuri:

3. Pasuria nr. 1, apartament banimi me sipërfaqe 57 m², i blerë në janar të vitit 2006, për vlerën 1.9 milionë lekë

3.1 Në Deklaratën “Vetting” kjo pasuri deklarohet me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, e llojit apartament me sipërfaqe 57 m², me adresë rruga “***.***”, Tiranë, fituar me kontratë shitblerje nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.1.2006. Vlera 1.9 milionë lekë, pa deklaruar pjesën takuese në pronësi.

Burimi i krijimit deklarohet: (i) Kursime personale në shumën 200.000 lekë; (ii) Hua 500.000 lekë nga babai, që vijnë nga të ardhura personale dhe kursime të vëllait ***.***, nga emigracioni; (iii) Hua 6.000 euro nga motra ***.*** dhe bashkëshorti i saj ***.***, që vijnë si të ardhura nga emigracioni në Mbretërinë e Bashkuar; (iv) Hua 3.000 euro nga xhaxhai ***.***, krijuar me të ardhura nga emigracioni.

3.2 Në DV-2006 kjo pasuri deklarohet: shtëpi banimi, sip. 57 m², rruga “***.***”, Tiranë, blerë në datë ***.1.2006. **Si burim krijimi** për këtë pasuri deklarohen vetëm huat nga babai (500.000 lekë) dhe xhaxhai (3.000 euro), si dhe nga e motra dhe bashkëshorti i saj (6.000 euro).

3.3 Nga krahasimi i deklaratës periodike të vitit 2006 me atë “Vetting”, rezulton se ka pasaktësi lidhur me burimin e krijimit, pasi në DV-2006 nuk deklarohet si burim përdorimi i kursimeve të subjektit në shumën 200.000 lekë dhe as pakësimi i tyre.

4. Për sa i përket **burimit të krijimit** të kësaj pasurie, deklaruar në Deklaratën “Vetting”, krahasuar me deklaratat periodike, analizojmë si vijon:

4.1 Lidhur me kursimet personale (i): Në DV-2005, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar për herë të parë se zotëron si kursime shumën prej 200.000 (dyqind mijë) lekë, *cash*. Gjithashtu ka deklaruar të ardhura nga paga e tij për vitin 2005, të cilat rezultojnë në shumën 787.398² (shtatëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e treqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë, si dhe shpenzime qiraje në shumën 200.000 (dyqind mijë) lekë. Nga analiza financiare e të ardhurave dhe shpenzimeve të vitit 2005, pasi zbriten shpenzimet dhe kursimi i deklaruar, rezulton se diferenca e mbetur nga të ardhurat, prej rreth 387.398 (treqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e treqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë, është e pamjaftueshme për të mbuluar konsumin minimal vjetor të një familjeje me katër anëtarë³.

4.1.1 Nga analiza e kryer për vitin 2005 edhe Komisionit i ka rezultuar se subjekti nuk mbulon me burime të ligjshme shpenzimet dhe kursimet, me një balancë negative në vlerën - 199.945 (njëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e dyzet e pesë) lekë. Edhe pse ka rezultuar me balancë negative për vitin 2005, trupi gjykues i Komisionit në arsyetimin e

² Sipas vërtetimit nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, datë ***.10.2016.

³ Referuar të dhënave zyrtare të INSTAT-it, që aplikohen edhe nga ILDKPKI-ja për konsumin vjetor.

vendimit ka arritur në përfundimin se: “Në lidhje me balancën financiare negative, duke marrë në konsideratë shpjegimet e dhëna nga subjekti për ndjekjen e një regjimi të rreptë financiar, si dhe ndihmat materiale të dhëna gjatë kësaj periudhe nga vjehri dhe vëllai i tij, konfirmuar me deklaratimet përkatëse, ajo rezulton të jetë e papërfillshme dhe nuk mund të arrihet në konkluzionin që kemi të bëjmë me shkelje ligjore që mund të çojnë deri në shkarkimin e subjektit nga detyra⁴”.

4.1.2 **Komisioneri Publik** vlerëson se përfundimi i Komisionit mbi burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e kursimeve në vlerën prej 200.000 (dyqind mijë) lekësh, deri në vitin 2005, deklaruar si burim krijimi i pasurisë në Deklaratën “Vetting”, është i gabuar, pasi nuk mbështetet në dokumentet provuese që vërtetojnë deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, detyrim ky i parashikuar në nenin D të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 32 të ligjit nr. 84/2016. Shpjegimet e dhëna nga subjekti për ndjekjen e një regjimi të rreptë ushqimor, si dhe ndihmat materiale të dhëna gjatë kësaj periudhe nga vjehri dhe vëllai i tij, mbeten thjesht në nivel deklarativ.

4.2 Lidhur me huan marrë nga babai i subjektit, z. ***,*** (ii): Në Deklaratën “Vetting” si dhe në DV-2006, si një nga burimet për krijimin e pasurisë, subjekti ka deklaruar hua në shumën 500.000 (pesëqind mijë) lekë, marrë nga babai i tij, z.***.***. Sipas deklaratimeve, të ardhurat që kanë shërbyer si burim i huas janë siguruar nga puna në bujqësi e të atit dhe puna në emigracion, Greqi, e vëllait, z.***.***. Rezulton se deklarimi i kësaj marrëdhënie huaje nuk shoqërohet dhe provohet me dokumentacionin justifikues ligjor, referuar dhe udhëzimit nr. 4095 prot., datë 10.10.2016, dalë në zbatim të nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

4.3 Lidhur me huan e marrë nga xhaxhai z. ***,*** (iii): Në Deklaratën “Vetting” dhe DV-2006, si një nga burimet për krijimin e pasurisë, subjekti ka deklaruar hua në shumën 3.000 euro, marrë nga xhaxhai i tij z.***.***. Sipas deklaratimeve, të ardhurat që kanë shërbyer si burim i huas janë siguruar nga puna në bujqësi e xhaxhait dhe kursime nga emigracioni në Greqi. Edhe në këtë rast, rezulton se deklarimi i kësaj marrëdhënie huaje nuk shoqërohet dhe provohet me dokumentacion justifikues ligjor.

4.4 Komisioni, bazuar në pikën 4, të nenit 32,⁵ të ligjit nr. 84/2016, i ka konsideruar babain dhe xhaxhain e subjektit, “*person tjetër të lidhur*”, që mbartin detyrimin për justifikimin e ligjshmërisë së burimit të krijimit të të ardhurave/huave të dhëna. Në këto kushte, subjekti ka paraqitur disa akte, pas administrimit të të cilave, Komisioni ka konkluduar se nuk ka dyshime në lidhje me aftësinë huadhënëse të babait të subjektit dhe xhaxhait të tij, që kanë mundësuar huadhënien për subjektin e rivlerësimit në vlerat respektive.

4.5 Në vlerësimin e **Komisionerit Publik**, ky konkluzion nuk është i bazuar në prova dhe në dispozitat e ligjit nr. 84/2016. Nga analizimi i provave, dokumentacioni i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit për të provuar aftësinë huadhënëse të babait⁶ dhe xhaxhait⁷ të tij, disa prej dokumenteve, përveçse nuk plotësojnë kushtet formale ligjore (sepse janë vetëdeklarime, dokumente pa vulë apostile, me përkthim të thjeshtë nga gjuha greke, pa u vërtetuar nënshkrimi i përkthyesit nga Noteri Publik), nuk janë dokumente provuese në kuptim të nenit 32, pika 1,

⁴ Për më tepër, referohuni f. 12 të vendimit të KPK-së.

⁵ Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të tyre.

⁶ Si burim deklarohen kursimet personale dhe të ardhurat nga emigracioni i djalit tjetër, z. ***.***; mbështetur, ndër të tjera, në deklaratë pa datë me shkrim dore, të vëllait, z. ***.***, ku deklaroi se ka qenë emigrant dhe realizonte të ardhura mesatare mujore 1.500 - 2.000 euro/muaj. Për periudhën e qëndrimit në Greqi, vëllai, z. ***.***, ka paraqitur kontratë qiraje të vitit 2001, kartë për leje qëndrimi greke, si dhe dokumente mbi pagesën e sigurimeve shoqërore dhe vërtetim për pajisje me kodin fiskal tatimpaguesi, në datë ***.2.2001.

⁷ Vërtetim nr. *** prot., datë ***.6.2018, nga Njësia administrative ***, Pogradec, ku rezulton se z. ***.*** realizon nga toka bujqësore të ardhura vjetore në shumën 111.465 lekë.

të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

4.5.1 Për sa i përket të ardhurave të deklaruara si të realizuara nga toka bujqësore, për babain ***.*** dhe xhaxhain ***.***, referuar dhe konfirmimit të Njesisë Administrative ***, rezulton se ka mungesë dokumentacioni zyrtar për të provuar shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe, si të tilla, këto të ardhura nuk plotësojnë kushtet për t'u konsideruar si të ardhura të ligjshme, në kuptim të nenit D, pika 3, e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

4.6 Lidhur me huan e marrë nga personi tjetër i lidhur, motra znj. ***.*** dhe bashkëshorti i saj, z. ***.*** (iv): Në Deklaratën “Vetting” dhe në DV-2006, si një nga burimet për krijimin e pasurisë, subjekti ka deklaruar hua në shumën 6.000 euro, marrë nga motra ***.*** dhe bashkëshorti i saj, z. ***.***. Edhe në këtë rast, rezulton se deklarimi i kësaj marrëdhënie huaje nuk shoqërohet dhe provohet me dokumentacionin justifikues ligjor.

4.6.1 Subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e provës për ekzistencën e aftësisë financiare të personit tjetër të lidhur për të dhënë hua, ka paraqitur disa dokumente, nga vlerësimi i të cilave, Komisioni ka konkluduar se: “... nuk ka dyshime në lidhje me aftësinë huadhënëse të shtetasve ***.*** dhe ***.*** ...⁸”.

4.6.2 Në arritjen e këtij konkluzioni, duket se Komisioni është mjaftuar me faktin se, sipas konfirmimeve të llogarive bankare, personi tjetër i lidhur, motra e subjektit, ka pasur në llogari, në këtë periudhë, shumën 8.600 euro⁹.

4.7 Në vlerësimin e **Komisionerit Publik**, konkluzioni i Komisionit nuk është i bazuar në gjendjen faktike të akteve¹⁰ të administruara në dosje dhe nuk është në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 84/2016. Komisioni, bazuar në nenin 49 të këtij ligji, ka administruar dokumentacion bankar për llogaritë e personave të tjerë të lidhur. Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarive bankare të znj. ***.*** në ***.*** Bank, rezulton se vetë subjekti në dy raste ka depozituar shuma në llogarinë në euro të personit tjetër të lidhur, pranë kësaj banke. Konkretisht në vitet 2005 - 2006 janë kryer disa depozitime në këtë llogari me përshkrimin: “pagesë për studime”, nga të cilat rezulton se janë depozituar nga subjekti: (i) në korrik 2006, shuma 5.000 euro, (ii) në shtator 2006, shuma 6.000 euro dhe në tetor 2007 janë tërhequr 5.000 euro nga subjekti me prokurë. Ndërkohë që subjekti ka deklaruar në DV-2008 se ka shlyer plotësisht detyrimin ndaj së motrës dhe kumatit të tij.

4.7.1 Nëse depozitimet e mësipërme nga subjekti në vitin 2006, në vlerën totale prej 11.000 euro, do të përlllogariteshin në analizën financiare të subjektit për këtë vit, ato do të ndikonin drejtpërdrejt në pamundësinë e tij financiare për të mbuluar shpenzimet e këtij viti me burime të ligjshme (sjellim në vëmendje se në këtë vit subjekti ka investuar në blerjen e pasurisë nr. 1).

4.7.2 Lidhur me këtë fakt, Komisioni nuk ka pyetur subjektin mbi shumën me të cilat ka kredituar llogarinë e motrës së tij, ndërkohë që kjo e fundit i ka dhënë hua shumën 6.000 euro, rrethanë e cila në optikën e Komisionerit Publik do të duhej të hetohej në mënyrë shteruese.

4.7.3 Për sa më sipër, në vlerësimin e Komisionerit Publik, dokumentacioni i paraqitur për personat e tjerë të lidhur, motrën, znj. ***.***, dhe kumatit e subjektit, z. ***.***, mbështet

⁸ Për më tepër, referohuni në faqen 12 të vendimit të KPK-së.

⁹ Për më tepër, referohuni në faqen 11 të vendimit të KPK-së.

¹⁰ (i) Deklaratë me shkrim dore të motrës dhe kumatit, *pa datë*, në të cilën deklarohet se në vitin 1997-2009 kanë qenë emigrantë në Angli, si dhe kanë deklaruar punëdhënësit (kumati) për këtë periudhë; (ii) Nxjerrje të llogarisë bankare nga ***.*** Bank, në emër të motrës dhe kumatit; (iii) Numrat e sigurimit të motrës dhe kumatit në Mbretërinë e Bashkuar; (iv) Nxjerrje llogarie bankare nga banka në Mbretërinë e Bashkuar, ku vërtetohen disa kreditime/pagesa në favor të kumatit, z. ***.***, të shkëputura në kohë; (v) Korrespondencën *online* të znj. ***.*** me Bankën “****” në Mbretërinë e Bashkuar, ku rezulton se janë kërkuar informacione mbi llogaritë bankare.

deklarimin e tyre mbi jetesën dhe mundësinë e punësimit në Mbretërinë e Bashkuar, por asnjë prej këtyre akteve nuk provon të ardhurat e realizuara nga punësimi.

4.7.4 Në lidhje me ligjshmërinë e të ardhurave të motrës ***.*** dhe kunatit ***.***, aktet e paraqitura nuk kanë vlerë provuese në kuptim të nenit 32, pika 1, të ligjit nr. 84/2016. Nga ana formale, këto dokumente nuk kanë fuqi provuese, sepse paraqiten si kopje të thjeshta, pa vulë apostile, disa pa përkthim dhe të tjerat të përkthyer, por në mungesë të vërtetimit të nënshkrimit të përkthimit nga Noteri Publik.

4.7.5 Njëkohësisht nuk plotësojnë kushtet për t'u konsideruar si të ardhura të ligjshme, pasi këto dokumente nuk përmbajnë të dhëna për pagimin e detyrimeve tatimore në shtetin ku janë realizuar të ardhurat, në referencë të nenit D, të aneksit të Kushtetutës.

4.8 Komisioni ka marrë të mirëqena burimet e deklaruara për krijimin e kësaj pasurie dhe ka analizuar mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit për të mbuluar me burime të ligjshme shpenzimet e deklaruara gjatë vitit 2006. Edhe në këtë rast, nga analiza, Komisionit i ka rezultuar se subjekti nuk mbulon me burime të ligjshme shpenzimet e këtij viti për një diferencë negative prej - 205.825 (dyqind e pesë mijë e tetëqind e njëzet e pesë) lekë¹¹.

4.8.1 Edhe pse ka rezultuar me balancë negative për vitin 2006, trupi gjykues i Komisionit në arsyetimin e vendimit ka mbajtur të njëjtin qëndrim, se: *“Në lidhje me balancën financiare negative, duke marrë në konsideratë shpjegimet e dhëna nga subjekti për ndjekjen e një regjimi të rreptë financiar, si dhe ndihmat materiale të dhëna gjatë kësaj periudhe nga vjehri dhe vëllai i tij, konfirmuar me deklaratimet përkatëse, ajo rezulton të jetë e papërfillshme dhe nuk mund të arrihet në konkluzionin që kemi të bëjmë me shkelje ligjore që mund të çojnë deri në shkarkimin e subjektit nga detyra”*.

4.8.2 **Komisioneri Publik** vlerëson se përfundimi i Komisionit për ligjshmërinë e të ardhurave për të mbuluar shpenzimet e deklaruara nga subjekti për vitin 2006, është i gabuar, pasi nuk mbështetet në dokumente provuese që të vërtetojnë deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, detyrim ky i parashikuar në nenin D, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 32, të ligjit nr. 84/2016. Shpjegimet e dhëna nga subjekti për ndjekjen e një regjimi të rreptë ushqimor, si dhe ndihmat materiale të dhëna gjatë kësaj periudhe nga vjehri dhe vëllai i tij, mbeten thjesht në nivel deklarativ.

4.9 Duke përfunduar, për **pasurinë nr. 1**, në vlerësimin e **Komisionerit Publik** rezulton se, lidhur me burimet e deklaruara për krijimin e saj, subjekti nuk arrin të provojë bindshëm burimin e ligjshëm të kursimeve personale të deklaruara, si dhe burimin e ligjshëm të huave të deklaruara nga personat e tjerë të lidhur.

5. Pasuria nr. 2, apartament banimi me sip. 78.4 m², i blerë në maj të vitit 2016, për vlerën 75.000 euro

5.1 *Në Deklaratën “Vetting”*, subjekti ka deklaruar shtëpi banimi, apartament me sip. 78.4 m², me adresë Rruga e ***, Tiranë, blerë për shumën 75.000 euro, me kontratën nr. *** rep., dhe *** kol., datë ***.5.2016¹².

¹¹ Për më tepër, referohuni faqes 11 të vendimit të KPK-së.

¹² Nga aktet e administruara në dosje, rezulton se, më datë ***.5.2016, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e blerësit, dhe shoqëria e ndërtimit “****” sh.p.k, në cilësinë e shitësit, kanë lidhur një kontratë shitblerje me rezervë, me nr. *** rep., dhe nr. *** kol., para noteres publike ***.***, me objekt apartament me sip. 78.4 m² për çmimin 75.000 euro. Referuar të drejtave dhe detyrimeve të blerësit, pagesa e plotë e çmimit të apartamentit do të kryhet në dy këste, ku kësti i parë, në shumën 40.000 euro, rezulton se është shlyer, konfirmuar nga verifikimi i llogarive bankare të subjektit pranë ***-së. Për këstin e parë, subjekti ka depozituar shumën prej 10.000 euro, në datë ***.7.2014 dhe 15.000 euro, në datë ***.5.2016. Në datën ***.5.2016 rezulton e kredituar nëpërmjet transfertës bankare nga Turqia shuma prej 14.951.83 euro. Shuma e akumuluar prej 40.000 euro është transferuar në llogarinë bankare të noteres ***.***, me përshkrimin: *“tjetërsim pasurie sipas kontratës për blerje pasurie nr. *** rep., *** kol., datë ***.5.2016”*. Ndërsa për këstin e dytë, prej 35.000 euro, palët kanë rënë dakord që të shlyhet nëpërmjet llogarisë bankare të noterit, deri në maj të vitit 2019. Nga korrespondenca e ndjekur e Komisionit me ZVRPP-në Tiranë,

5.2 **Burimi i krijimit** deklarohet: (i) Kursime nga të ardhurat prej punës së deklaruesit dhe bashkëshortes, 25.000 euro; (ii) Hua në shumën 15.000 euro, nga ***.*** dhe ***.***, përkatësisht, vëllai i bashkëshortes së subjektit me bashkëshorten e tij, shtetase turke. Burimi i huas, nga kursimet e tyre prej punës në kompaninë “****”, dhe menaxhimi i dy dyqaneve shitje me shumicë dhe pakicë, mobilieri me sip. 2.000 m² dhe 3.600 m², ndodhur në Turqi. Shuma e huas është transferuar në Bankën ***.*** (***) në datën ***.5.2016; dhe (iii) Kredi bankare pranë ***-së, në shumën 1.5 milionë lekë, datë ***.12.2016.

5.3 *Në DV-2016*, ku kjo pasuri është deklaruar për herë të parë, deklarohen saktësisht të njëjta të dhëna si më sipër.

5.4 **Komisioneri Publik**, nga analizimi tërësor i provave të administruara, bazuar në kërkesat e nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 32/4, të ligjit nr. 84/2016, vlerëson se edhe në këtë rast arsyetimi dhe konkluzionet e Komisionit në lidhje me burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie nuk gjejnë mbështetje ligjore. Referuar gjendjes së akteve dhe vlerës provuese të tyre, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e tjerë të lidhur me të nuk kanë arritur të justifikojnë bindshëm burimin e krijimit të pasurisë. Komisioni, në mënyrë të gabuar, ka mbajtur qëndrimin në lidhje me huan prej 15.000 euro, të marrë nga personat e tjerë të lidhur, se: *“shuma është transferuar nëpërmjet ***.***... çka do të thotë se kemi të bëjmë me një transfertë nga banka në bankë, duke legjitimuar kështu burimin e të ardhurave që justifikon këtë gjendje financiare në bankën e origjinës, prej nga është bërë transfertat”* (f. 25 e vendimit).

5.5 Komisioneri Publik çmon se posedimi ose jo i likuiditeteve në llogari bankare apo transfertat bankare, nuk janë fakte dhe prova që legjitimojnë burimin e të ardhurave. Vlerësimi mbi ligjshmërinë e burimit të pasurisë del si rezultat i hetimit administrativ të Komisionit dhe bëhet vetëm nëse plotësohen kushtet e nenit D, pika 3, të aneksit të Kushtetutës. Pra identifikohet dhe provohet burimi i ligjshëm dhe pagimi i detyrimeve tatimore.

5.6 Nga aktet e administruara në dosje, rezulton se huaja prej 15.000 euro është transferuar në llogarinë bankare të subjektit pranë ***, në datë ***.5.2016. Mbi mundësinë e personave të tjerë të lidhur për kursimin e shumës dhe ligjshmërinë e saj, subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës dokumenti nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Republika e Turqisë, për shtetasit ***.*** dhe ***.***.***. Ky dokumentacion tregon se për shtetasen ***.***.*** janë paguar sigurime shoqërore për periudhat: viti 2006 (1 muaj); viti 2007 (2 muaj), si dhe për periudhën mars 2012-2017. Për shtetasin ***.*** rezulton se janë paguar sigurime shoqërore për periudhën dhjetor 2012 - 2017.

5.7 Ndryshe nga përfundimi i Komisionit se: *“duke marrë në konsideratë analizën e llogarive bankare, deklaratimet e subjektit... nuk ka dyshime në lidhje me ligjshmërinë e burimit të krijimit të këtyre të ardhurave monetare”* (f. 27 e vendimit), Komisioneri Publik çmon se aktet e administruara nuk të krijojnë bindjen se të ardhurat e deklaruara si hua justifikojnë burimin e ligjshëm të tyre, pasi dokumentacioni i paraqitur nga subjekti prej Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Turqi, merret me rezervë për vlerën provuese të tyre.

5.8 Në aspektin formal, ky dokumentacion nuk shoqërohet me vulën apostile, si dhe nuk vërteton se sa janë të ardhurat e realizuara nga personat e tjerë të lidhur për periudhën deri në maj 2016, kur është dhënë huaja. Edhe në këtë rast, rezulton se Komisioni nuk ka hetuar apo të ketë kryer analizë financiare mbi mundësinë e tyre për të dhënë hua shumën prej 15.000 euro, duke marrë në konsideratë këtu shpenzimet e tyre të nevojshme për jetesë.

konfirmohet se kjo pasuri është e regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit, dhe sipas kartelës së pasurisë së datës ***.6.2018, në seksionin “E”, rezulton se kjo pasuri është e bllokuar në favor të shitësit deri në likuidimin e plotë të çmimit të shitjes.

5.9 Duke përfunduar për **pasurinë nr. 2**, në kuptim të nenit D/3, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 32/4, të ligjit nr. 84/2016, vlerësojmë se subjekti i rivlerësimit gjendet në pamundësi financiare për mbulimin me të ardhura të ligjshme në blerjen e kësaj pasurie.

6. Mosdeklarimi i pasurisë

6.1 Nga hetimi administrativ i Komisionit (nga të dhënat e Regjistrimit Noterial Shqiptar pranë Ministrisë së Drejtësisë¹³) ka rezultuar se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, së bashku me familjarët e saj (prindërit, e motra dhe vëllai), në cilësinë e bashkëpronares me pjesë të barabarta dhe e pandarë të pasurisë së paluajtshme truall me sip. 178 m² dhe ndërtesë me sip. 100 m², ka nënshkruar një kontratë shitje më datë ***.1.2018, me nr. *** rep., dhe nr. *** kol., për kalimin e pronësisë së këtyre pasurive, blerësit ***.***, për çmimin 1.3 milionë lekë. Nisur nga ky fakt, Komisionit i ka rezultuar se këto pasuri nuk janë deklaruar ndonjëherë, as në deklaratat periodike ashtu dhe në atë “Vetting”, për rrjedhojë nga Komisioni është konsideruar si pamjaftueshmëri në deklarimin e pasurisë. Për të provuar të kundërtën, subjekti ka paraqitur shpjegimet e tij, si gjatë hetimit administrativ, ashtu dhe gjatë seancës dëgjimore.

6.2 Komisioni, pasi ka vlerësuar shpjegimet e subjektit, si dhe duke u bazuar në interpretimet e legjislacionit të kohës dhe atij në fuqi¹⁴, ka arritur në konkluzionin se: *“është më se e qartë se familja bujqësore është një grupim, përbërja e së cilës është në ndryshim të vazhdueshëm, ku hyjnë e dalin anëtarë për shkak të veprimeve të caktuara juridike ..., si dhe për shkak të ligjit. Për rrjedhojë, personi i lidhur, me martesën e kryer me subjektin, ka humbur statusin e anëtares së familjes bujqësore të përfaqësuesit të saj... Sa më sipër, pronësia e shtëpisë së banimit (përfshirë edhe pronësinë mbi truallin) nuk gjen rregullim ligjor në ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”... Pavarësisht firmosjes nga ana e personit të lidhur me subjektin (bashkëshortja e tij), në kontratën e shitblerjes së shtëpisë së banimit, kemi të bëjmë me një interpretim të gabuar të ligjit nga noteri publik, duke e konsideruar shtëpinë e banimit në fshat... si një pasuri në pronësi të familjes bujqësore. Për rrjedhojë, si subjekti, ashtu dhe personi i lidhur me të, nuk kanë pasur detyrimin ligjor të deklarojnë këtë pasuri...”* (f. 29, 30 dhe 31 e vendimit).

6.3 Nga hetimi administrativ i Komisionit¹⁵ ka rezultuar gjithashtu se në pronësi të babait të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e përfaqësuesit të familjes bujqësore, në zonën kadastrale nr. ***, ***, Pogradec janë të regjistruara dhe 6 pasuri të llojit arë, me status regjistrimi, “familjare”¹⁶. Nga korrespondenca me Bashkinë Pogradec, nga Njësia Administrative ***, me anë të shkresës nr. *** prot, datë ***.6.2018, konfirmohet se sipas certifikatës familjare të z. ***.***, babai i bashkëshortes së subjektit, në përbërjen e familjes bujqësore, më datë 1.8.1991, rezulton edhe personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit.

¹³ Referuar përgjigjes së ardhur nga Ministria e Drejtësisë me nr. *** prot., datë ***.1.2018.

¹⁴ Si ligji nr. 7512, datë 10.8.1991, “Për mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit” (i shfuqizuar), Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 432, datë 14.8.1995, “Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në zonën urbane të fshatit” (i shfuqizuar), rregullimit ligjor të tjetërsimit të sendeve të përbashkëta sipas Kodit Civil të vitit 1981, bashkëpronësinë midis anëtarëve të familjes bujqësore sipas nenit 222 të Kodit Civil në fuqi, ligjit nr. 8337, datë 30.4.1998, “Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave”, si dhe në interpretim të jurisprudencës në lidhje me familjen bujqësore.

¹⁵ Referuar shkresës së ZVRPP-së Pogradec, protokolluar pranë Komisionit me nr.*** prot., datë ***.1.2018.

¹⁶ (i) “Arë”, me sip. 1.092 m² dhe sip.1.071 m², sipas AMTP-së nr. ***, LN.10.1996, statusi “Familjare”, me datë lëshimi të certifikatës ***.3.2008; (ii) “Arë”, me sip. 1.120 m² dhe sip.1.120 m², sipas AMTP-së nr. ***, LN.10.1996, statusi “Familjare”, me datë lëshimi të certifikatës ***.3.2008; (iii) “Arë”, me sip. 2.177 m² dhe sip. 2.120 m², sipas AMTP-së nr. ***, LN.10.1996, statusi “Familjare”, me datë lëshimi të certifikatës ***.3.2008; (iv) “Arë”, me sip. 2.000 m² dhe sip.1.995 m², sipas AMTP-së nr. ***, LN.10.1996, statusi “Familjare”, me datë lëshimi të certifikatës ***.3.2008; (v) “Arë”, me sip. 2.250 m² dhe sip.1.600 m², sipas AMTP-së nr. ***, LN.10.1996, statusi “Familjare”, me datë lëshimi të certifikatës ***.3.2008; dhe (vi) “Arë”, me sip. 600 m², statusi “Familjare”, me datë lëshimi të certifikatës ***.3.2008.

6.4 Në vijim të arsyetimit të mësipërm, Komisioni edhe në këtë rast ka konkluduar se: “... pavarësisht se znj. ***.*** (personi i lidhur) ka qenë anëtare e familjes bujqësore... prej vitit 1997, kur ajo është shkëputur nga kjo familje për shkak të martesës... ajo nuk mund të përfitojë të drejta pronësore mbi pasuritë e kësaj familje bujqësore (përveç për shkaqe ligjore, si p.sh. trashëgimia) e për rrjedhojë, si subjekti i rivlerësimit, ashtu edhe znj. ***.***, nuk kanë pasur detyrim ligjor për deklarimin e kësaj pasurie në ILDKPKI” (f. 33 e vendimit).

6.5 Referuar shkresës së ZVRPP-së Pogradec, protokolluar pranë Komisionit me nr. *** prot., datë ***.1.2018, rezulton se edhe i ati i subjektit të rivlerësimit, z. ***.***, në zonën kadastrale nr.***, ***, Pogradec ka të regjistruara 6 pasuri të llojit truall dhe arë¹⁷, me status regjistrimi, “familjare”. Nga korrespondenca e Komisionit me Bashkinë Pogradec, nga Njësia Administrative ***, konfirmohet se në certifikatën familjare të z. ***.***, babai i subjektit, më datë 1.8.1991, në përbërjen e familjes bujqësore rezulton edhe subjekti i rivlerësimit.

6.6 **Komisioneri Publik**, nga analizimi i akteve të administruara, pretendimeve dhe provave të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, vlerëson se arsyetimi dhe përfundimi i arritur nga Komisioni, se si shkak martesë humbasin të drejtat e bashkëpronësisë në tërësi të familjes bujqësore, është rrjedhojë e keqinterpretimit të ligjit civil.

6.7 Komisioneri Publik vlerëson se si subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të (bashkëshortja), sipas gjendjes familjare të datës 1.8.1991 kanë qenë pjesëtarë të familjeve bujqësore respektive dhe kanë përfituar tokë bujqësore sipas ligjit nr. 7501/1991, “Për tokën”..., regjistruar në ZVRPP Pogradec, me statusin “familjar”. Bazuar në nenin 222,¹⁸ të Kodit Civil, ata tërheqin të drejta reale pronësore mbi pasuritë e mësipërme dhe sipas nenit 4, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 9049/2003 për deklarimin e pasurive, të ndryshuar, ata kanë pasur detyrimin ligjor t’i deklarorin këto pasuri dhe të drejtat reale mbi to sipas Kodit Civil¹⁹.

6.8 Referuar ligjit nr. 7501/1991, ligjvënësi e njohu bashkëpronësinë mbi tokën bujqësore për të gjithë ata anëtarë të familjeve shqiptare që banonin dhe jetonin në fshat apo në ferma të ndryshme, por që ishin në përbërjen familjare të familjes bujqësore para daljes së këtij ligji, datë 19.7.1991. Pra në këtë rast, vetëm ata persona që kishin lindur para datës 1.8.1991, kishin të drejtë të përfitonin nga dispozitat e ligjit, për t’u bërë bashkëpronarë të tokës bujqësore, e që do të përfitonin pas shpërbërjes së kooperativave dhe fermave bujqësore. Numri i anëtarëve të gjallë të familjeve bujqësore dhe, rrjedhimisht, numri i personave që do të ishin bashkëpronarë mbi tokën bujqësore, ishte një numër i përcaktuar me miratimin e ligjit “Për tokën” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 255, datë 2.8.1991, “Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore²⁰”. Në analizë të këtyre normave, konstatojmë se natyra e bashkëpronësisë së familjes bujqësore në këtë rast, referuar edhe nenit 222, të Kodit Civil të vitit 1994, nuk mund të ndryshojë nën arsyetimin e pakësimit apo shtimit, si shkak largimi apo ardhje të anëtarëve në familjen bujqësore nga martesë. Natyra juridike e bashkëpronësisë në tërësi e familjes bujqësore paraqitet e tillë që, për sa kohë nuk është pjesëtuar sipas rregullave të Kodit Civil,

¹⁷ (i) “Truall”, me sip. 300 m² dhe ndërtim me sip. 160 m², për të cilën nuk është bërë pajisja me certifikatë pronësie; (ii) “Arë”, me sip. 455 m² dhe sip. 488 m², sipas AMTP-së nr. ***, LN.10.1996, statusi “Familjare”, me datë lëshimi të certifikatës ***.9.2006, pa referencë në Arshivë; (iii) “Arë”, me sip. 1550 m² dhe sip. 1524 m², sipas AMTP-së nr. ***, LN.10.1996, statusi “Familjare”, me datë lëshimi të certifikatës ***.7.2003, pa referencë në Arshivë; (iv) “Arë”, me sip.831 m² dhe sip.858 m², sipas AMTP-së nr. ***, LN.10.1996, statusi “Familjare”, me datë lëshimi të certifikatës ***.12.2002; (v) “Arë”, me sip. 2.250 m², sipas AMTP-së nr. ***, statusi “Familjare”, për të cilën nuk është bërë pajisja me certifikatë pronësie, dhe (vi) “Arë”, me sip. 3520 m², sipas AMTP-së nr. ***, statusi “Familjare”, me datë lëshimi të certifikatës ***.8.2003.

¹⁸ “Pronësia mbi pasurinë e anëtarëve të familjes bujqësore, u përket në tërësi anëtarëve të saj, të cilët, nëpërmjet punës ose të drejtave të tjera të fituara, kanë kontribuar në krijimin e në mbajtjen e ekonomisë bujqësore.”

¹⁹ Togfjalëshi “sipas Kodit Civil” është shtuar nga neni 4 i ligjit nr. 42/2017.

²⁰ Sipas pikës 2/1, 2 të këtij vendimi: “Në të gjitha rastet toka ndahet përpjesëtimisht për çdo familje sipas numrit të frymëve të gjendjes civile në datën 1 gusht 1991. Në numrin e frymëve të familjes bujqësore anëtare të kooperativës bujqësore do të llogariten gjithë frymët e saj, si fëmijët, nxënësit, studentët, ushtarët, pensionistët, anëtarët e familjeve kooperativiste që punojnë me kontratë të përkohshme dhe refugjatët, pavarësisht nga seksi...”.

secili prej bashkëpronarëve të drejta dhe detyrime ndaj asaj pasurie, qëndrim ky i konsoliduar edhe nga jurisprudenca e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë²¹.

6.9 Bashkëpronësia midis anëtarëve të familjes bujqësore paraqitet si bashkëpronësi në tërësi dhe, për sa kohë nuk është bërë pjesëtimi sipas nenit 207, të Kodit Civil, ndaj saj zbatohen rregullat e përgjithshme dhe të posaçme të këtij kodi për kryerjen e veprimeve juridike në tërësi apo dhe disponimit mbi to në veçanti. Në këtë kuptim, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e bashkëpronares me pjesë takuese ideale të 1/5, ka nënshkruar kontratën e shitjes më datë ***.1.2018, çka prezumohet se ka marrë dhe pjesën takuese të çmimit të shitjes prej 1.3 milionë lekësh. Në cilësinë e personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit, ajo ka pasur detyrimin ligjor të deklarimit të të gjitha pasurive të akumuluar ndërr vite dhe paraqitjen e të gjithë dokumentacionit që justifikon vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të tyre, sipas neneve 30 dhe 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Në këtë drejtim mbajmë në konsideratë edhe qëndrimin e Kolegjit në vendimin (JR) nr. 1/2019.

6.10 Komisioneri Publik vlerëson se nuk ka asnjë rrethanë ligjore që subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, të mos deklaronin saktësisht dhe mjaftueshmërisht pasuritë e tyre në pronësi dhe bashkëpronësi apo të drejtat mbi to. Neni D, pikat 1, 2 dhe 5 të aneksit të Kushtetutës, neni 32, pika 1 të ligjit nr. 84/2016, pika 7 e udhëzimit të ILDKPKI-së, datë 10.10.2016, si dhe formulari i deklarimit të pasurisë për procesin e rivlerësimit 2017, detyron subjektin e rivlerësimit për deklarimin saktësisht dhe mjaftueshmërisht të “pasurisë” së tij dhe personave të lidhur me të, si dhe “burimin” në momentin e krijimit të saj. Me burim në këtë rast përfshihet si origjina, pra shkaku apo veprimi i ligjshëm që passjell disponimin dhe të drejtat pronësore të pasurisë, ashtu dhe mjetet financiare që kanë shërbyer për krijimin e saj.

6.11 Bazuar në sa më sipër trajtuar, provohet se subjekti i rivlerësimit së bashku me personin e lidhur (bashkëshortja) ndodhen në kushtet e mosdeklarimit, deklarimit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, fakti i cili vjen ndesh me përcaktimet e nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Aplikimi i nenit 61/3, i ligjit nr. 84/2016, gjen zbatim si pasojë e kësaj gjendje fakti, konstatuar gjatë hetimit administrativ për qëllim të procesit të rivlerësimit. Në këtë drejtim mbajmë në konsideratë edhe vendimin (JR) nr. 7/2018 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

7. Mosmbulimi i shpenzimeve vjetore të subjektit nga të ardhura të ligjshme

7.1 Bazuar në analizën financiare mbi të ardhurat dhe shpenzimet, duke përlllogaritur vetëm ato të ardhura që në kuptim të nenit D, pika 3, e aneksit të Kushtetutës konsiderohen si të ligjshme, përveçse sa më sipër analizuam lidhur me vitet kur subjekti ka investuar për pasuritë nr. 1 dhe nr. 2 (vitet 2006 dhe 2016), për subjektin e rivlerësimit konstatohet gjithashtu se nuk mbulon me burime të ligjshme shpenzimet vjetore për vitet 2003 dhe 2004 (si dhe kursimet e deklaruara në vitin 2005, sikundër analizuar më sipër mbi burimet e krijimit të pasurisë nr. 1), respektivisht në shumat: **102.844 lekë** (njëqind e dy mijë e tetëqind e dyzet e katër lekë) dhe **123.343 lekë** (njëqind e njëzet e tre mijë e treqind e dyzet e tre lekë).

7.2 Pamundësia e subjektit për të mbuluar me burime të ligjshme shpenzimet e deklaruara, është konstatuar edhe nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, i cili, në përfundim, ka arsyetuar se: “...balancat financiare negative ndër vite janë të papërfillshme në lidhje me intensitetin e të ardhurave dhe të shpenzimeve të kryera...” (f. 36 e vendimit).

7.3 **Komisioneri Publik** vlerëson se ky konkluzion i përgjithshëm i Komisionit mbi intensitetin e të ardhurave dhe shpenzimeve të subjektit nuk gjen mbështetje ligjore, pasi në një ekonomi familjare të ardhurat e ligjshme duhet të mbulojnë në çdo rast shpenzimet e kryera për konsum, kursime dhe investime/pasuri. Ky është dhe qëllimi i dispozitës kushtetuese, neni D/3, kur shprehet se: “subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm

²¹ Referohu në vendimin Nr.00-2014-484 i Vendimit (69), datë 27.02.2014 dhe Nr. 00-2018-396 i Vendimit (30), datë 12.04.2018.

të pasurive dhe të të ardhurave”. Në të kundërt, nëse raporti i ligjshmërisë së të ardhurave me shpenzimet, kursimet apo investimet e kryera do të ishte i zhdrejtë, atëherë rrjedhimisht do të gjente zbatim neni 61/3, i ligjit nr. 84/2016, pra subjekti do të gjendej në situatën e deklarimit të pamjaftueshëm të pasurisë së tij.

7.4 Sa më sipër, provohet se edhe për vitet 2003 dhe 2004, krahas viteve 2005, 2006 dhe 2016, subjekti nuk mbulon me burime të ligjshme shpenzimet e deklaruara. Si rrjedhojë, subjekti gjendet në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, sipas nenit D/3, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

II. Çështje të tjera

8. Komisioneri Publik çmon të sjellë në vëmendje edhe informacionin e përcjellë nga DSIK-ja lidhur me subjektin e rivlerësimit, depozituar pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 16.11.2018, rrethanë kjo pas depozitimit të ankimit. Sikurse jeni në dijeni, Komisioneri Publik e ka përcjellë këtë informacion pranë Kolegjit, po në datë 16.11.2018.

III. Kërkimi i ankimit

9. Në përfundim të këtyre parashtrimeve, Komisioneri Publik çmon se:

9.1 Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur dhe të tjerë të lidhur me të, nuk arrijnë të justifikojnë bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave dhe pasurive të deklaruara, referuar nenit D, pika 3, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016;

9.2 Për vitet 2003, 2004 dhe 2005, nga analiza financiare, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për të justifikuar shpenzimet dhe kursimet e deklaruara;

9.3 Subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mosdeklarimit të pasurisë dhe deklarimit të pamjaftueshëm, referuar nenit D, pikat 1 dhe 5, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61/3, të ligjit nr. 84/2016;

9.4 Në interpretim të nenit D, pikave 3 dhe 5, të aneksit të Kushtetutës, nenit 33 dhe nenit 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë;

9.5 Bazuar në nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, dhe nenin 66, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 84/2016, kërkohet nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 58, datë 1.8.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Besnik Muçi.

KOMISIONERI PUBLIK

Darjel SINA